




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



“RADIO LLAPI”

Numri i Biznesit - 70399979

Pronar – Bajrush BEHRAMI

Radio LLAPI

Podujevë

“RADIO LLAPI”

Numri i Biznesit - 70399979

Kandidati për pronar : Gyltene BEHRAMI

Podujevë

Ref: 1906/758/LIC/ni

VENDIM

për refuzimin e kërkesës për transferimin e licencës pasardhësit të kualifikuar dhe ndryshimin e pronarit si person fizik të Radio Llapit, me seli në Podujevë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Llapi është Ofrues i Shërbimit Medial, i cili është i licencuar për transmetimin tokësorë të radio programeve, në gjuhën shqipe, në Komunën e Podujevës. Radio Llapi është radio stacion me mbulueshmëri lokale i cili është pajisur me licencë afatgjate me datën 28 gusht 2009 për një afat prej shtat (7) vitesh, pra deri me 28 gusht 2016 dhe e njëjta i është ripërtërirë, në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, edhe për shtatë (7) vite, që nënkupton se licenca e Radio Llapit është e vlefshme deri më 28 gusht 2023.
3. Kandidatja për pronare të Radio Llapit, ka parashtruar në Zyrën Ekzekutive të KPM-së një kërkesë për transferimin e licencës së Radio Llapit, si trashëgimtare e ligjshme të ndjerit z. Bajrush Behrami, pronar i deritanishëm i Radio Llapit.

Arsyetimi

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se, KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit te

frekuencave te transmetimit si dhe rregullon te drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik te cilët ofrojnë shërbime mediave audio-vizuale.

5. Neni 15, paragrafi 5, i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, siguron që: *“Në rast se i Licencuari vdes, ose vërtetohet paaftësia e tij shëndetësore me anë të vendimi gjyqësor apo përmes një dokumenti shëndetësor, ose i Licencuari si organizatë ndërpret veprimtarinë, shpërbëhet ose deklarohet i falimentuar nga një autoritet kompetent, KPM-ja mund ta përfundojë Licencën ose t’ia transferojë Licencën një pasardhësi të kualifikuar.”*
6. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t’i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t’iu dhënë një licencë”.*
7. Pas marrjes se informacionit për vdekjen e pronarit të Radio Llapit z. Bajrush Behramit, Komisioni, ka kontaktuar me familjaret e tij dhe i ka ftuar në një takim për ti informuar ata lidhur me mundësin e transferimi të licencës të Radio Llapit dhe për të parë vullnetin e tyre, nëse ata janë të interesuar për të vazhduar me veprimtarin e transmetimit.
8. Takimi është mbajtur në Zyrën Ekzekutive, më 16 gusht 2018, ndërsa, familjarët e pronarit të deritanishëm janë njoftuar lidhur me mundësin e transferimin e licencës tek një pasardhës i kualifikuar, kurse nga ana tjetër bashkëshortja e pronarit të ndjerë të Radio Llapi ka shprehur gatishmërinë për ta transferuar licencën.
9. Me datën 23 gusht 2018, kandidatja për pronarë të ri të Radio Llapi, znj. Gyltene Behrami ka dorëzuar në KPM, kërkesën për transferimin e licencës, ndërsa, KPM, përmes e-maili i ka përcjellë listën e dokumenteve të nevojshme si pjesë e kërkesës për transferim të licencës së Radio Llapi.
10. Në ndër kohë, kandidatja për pronare të Radio Llapi ka dorëzuar dokumente shtesë, mirëpo, nuk ka arritur që ta kompletoj kërkesën me dokumentacionin e nevojshëm.
11. Komisioni, konstaton se kandidatja për pronare të Radio Llapit, të cilës propozohet ti transferohet licenca e KPM-së, nuk ka dorëzuar kërkesën dhe dokumentacionin përcjellës në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa nuk i plotëson kushtet për miratim.

VENDIM

12. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 17 qershor 2019, merr vendim që ta refuzoj kërkesën e kandidates për pronare të Radio Llapit, znj. Gyltene Behrami për transferimin e licencës, për arsye të mos kompletimit të kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, për këtë ndryshim, sipas Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së si dhe udhëzimeve të Zyrës Ekzekutive të KPM-së.

13. Kandidatja për pronare të Radio Llapit ka të drejtë që, në të ardhmen e afërt, të dorëzoj sërish kërkesë për transferimin e licencës së Radio Llapit, e cila duhet të jetë e plotësuar në pajtueshmëri me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

14. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



17.06.2019

datë